

DANIEL KEHLMANN

**"F"**

ROMAN

---

BOTIMET TOENA



DANIEL KEHLMANN

“F”

*roman*

Përktheu nga origjinali gjermanisht  
Anna Kove

BOTIMET TOENA

Tiranë

Autori: Daniel Kehlmann

Titulli në original: F

Botoi në gjermanisht: Rowohlt Verlag GmbH, Reinbek bei Hamburg

█ Përkthimi i këtij libri u realizua me mbështetjen e Ministrisë  
█ Federale të Artit, Kulturës, Shërbimit Publik dhe Sportit, Austri

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Korrektore letrare: Sonila Kryeziu

Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

Kopertina: Erdita Oshafi

ISBN 9789928817181

© 2013 Rowohlt Verlag GmbH, Reinbek bei Hamburg

© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Lindemani i Madh



Vite më vonë, kur ata ishin të rritur dhe të mbërthyer secili pas fatkeqësisë së vet, asnjë nga djemtë e Artur Friedlandit, në fakt, nuk e dinte se e kujt kishte qenë ideja të shkonin te hipnotizuesi atë pasdite. Ishte viti 1984, Arturi nuk kishte asnjë zanat. Shkruante romane, që asnjë shtëpi botuese nuk donte t'i shtypte, dhe tregime, që herë pas here botoheshin nëpër revista. Nuk bënte asgjë tjetër, ndërsa e shoqja ishte mjeke okuliste dhe fitonte mirë.

Gjatë rrugës për atje, ai foli me të bijtë trembëdhjetëvjeçarë për Niçen dhe për markat e çamçakëzëve; debatuan për filmin vizatimor që po shfaqej në kinema mbi një robot, i cili ishte edhe shpëtimtar; hamendësuan pse *Yoda* fliste aq çuditshëm dhe pyetën nëse Supermeni ishte më i fortë se Batmani. Më në fund ndaluan përpara ca shtëpive me tarraca në një rrugë periferike. Arturi i ra borisë dy herë dhe disa sekonda më vonë u hap një derë shtëpie.

Djali i tij i madh, Martini, ishte ulur pranë dritares prej dy orësh dhe po i priste, i turbulluar nga padurimi dhe mërzia. Xhami ishte mjegulluar nga fryma e tij, ai kishte vizatuar me gisht fytyra serioze, të qeshura dhe disa me gojë të hapura. E fshinte xhamin herë pas

here dhe shikonte se si fryma e mbulonte me mjegull të hollë. Ora e murit trokiste e trokiste pa u ndalur; përse po zgjaste kaq shumë? Përsëri një makinë, mandej përsëri një tjetër, edhe një tjetër, por prapë nuk ishin ata.

Befas njëra u ndal dhe i ra borisë dy herë. Martini vrapoi nëpër korridor, pastaj pranë dhomës ku ishte shpërngulur e ëma, e cila s'donte ta shihte Arturin. Kishin kaluar katërmëdhjetë vjet që ai ishte zhdukur pa zhurmë dhe shpejt nga jeta e tyre, por ende e mundonte fakti se ai mund të ekzistonte pa pasur nevojë për ta. Martini vrapoi tatëpjetë shkallëve, përgjatë korridorit të poshtëm, doli jashtë dhe kaloi rrugën - aq shpejt sa nuk e pa makinën që po ecte me shpejtësi. Pranë tij klithën frenat, por ai tashmë u gjend ulur në sediljen e pasagjerit, me duar të lidhura mbi kokë dhe vetëm atëherë zemra i dha shenjë jete përmes një rrahjeje.

- O Zot, - tha Arturi me zë të ulët.

Makina, që për pak sa nuk vrau Martinin, ishte një *Volkswagen Golf* i kuq. Shoferi i binte tani borisë më kot, ndoshta mendonte se s'kish kuptim të mos bënte asgjë pas një incidenti të tillë. Pastaj i dha gaz dhe vazhdoi rrugën.

- O Zot, - tha Arturi sërish.

Martini fërkoj ballin.

- Si mund të jesh kaq budalla? - pyeti një nga binjakët në sediljen e pasme.

Martini ndjeu sikur ekzistenca e tij ishte ndarë dysh.



Ai ishte ulur këtu, por në të njëjtën kohë ishte edhe i shtrirë atje mbi asfalt, i palëvizshëm dhe kruspull. Iu bë se fati i tij nuk ishte përcaktuar ende, dyfishësia mund të ishte e vërtetë dhe, për një moment, ai kishte edhe një binjak, i cili pak nga pak po fikej atje jashtë.

- Zoti s'është këtu, - tha binjaku tjetër.

Arturi pohoi me kokë.

- Po, a është e vërtetë? Nëse Zoti ka në plan diçka tjetër për dikë. Çfarëdo qoftë. Atëherë, asgjë nuk mund të ndodhë.

- Zotit nuk i duhet të planifikojë asgjë. I mjafton vetëm dijenia. Nëse Zoti e di se dikë do ta përplasë makina, atëherë atë do ta përplasë makina. Nëse Zoti e di se dikujt asgjë nuk do t'i ndodhë, atëherë asgjë nuk do t'i ndodhë.

- Kjo s'mund të jetë e vërtetë. Atëherë nuk do të kishte fare rëndësi se çfarë bën njeriu. Babi, ku qëndron gabimi?

- Zoti nuk ekziston, - tha Arturi. - Ky është gabimi.

Të gjithë heshtën, më pas Arturi ndezi motorin dhe ata u larguan. Martini ndjeu se rrahjet e zemrës iu qetësuan. Pas pak minutash do t'i dukej sërish e natyrshme që ishte gjallë.

- Po në shkollë? - pyeti Arturi. - Si po shkon?

Martini e pa të atin në profil. Arturi kishte shtuar pak peshë; flokët e tij, në atë kohë ende të pathinjur, ishin të kërrëshur si gjithmonë, sikur të mos ishin krehur kurrë më parë.

- Matematika është e vështirë për mua, mund të ngel. Frëngjishtja është ende problem. Anglishtja jo më, për fat.

Ai foli shpejt, për të thënë sa më shumë të mundej, para se Arturi ta humbiste interesin.

- Në gjermanisht jam mirë, kemi një mësues të ri në fizikë, në kimi njësoj si gjithmonë, por me eksperimentet...

- Ivan, - pyeti Arturi, - a i kemi biletat?

- I ke në xhep, - u përgjigj njëri nga binjakët dhe, së paku tani, Martini e kuptoi se cili nga të dy ishte Ivani dhe cili ishte Eriku. I vështronte ata në pasqyrën e pasme. Si gjithmonë, diçka në lidhje me ngjashmërinë e tyre i dukej e gabuar, e ekzagjeruar, kundër natyrës. Vetëm pas disa vitesh jetë ata zunë të visheshin njësoj. Kjo fazë e shijimit të padallueshmërisë së njërit nga tjetri nuk do të përfundonte deri në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare, kur për një kohë të shkurtër as ata vetë nuk ishin të sigurt se cili prej tyre ishte kush. Pas kësaj, do të kishin gjithmonë ndjesinë se ata dikur e kishin humbur veten dhe se nga ajo kohë secili kishte bërë jetën e tjetrit; ashtu si Martini nuk do ta hiqte kurrë dyshimin, se në të vërtetë kishte vdekur në rrugë atë pasdite.

- Mos shih ashtu si budalla, - tha Eriku.

Martini u rrotullua dhe e kapi Erikun për veshi. Pothuajse e kapi, sepse i vëllai iu shmang, ia kapi krahun dhe ia përdrodhi përperjetë shpinës. Ai bërtiti.

Eriku e lëshoi dhe konstatoi i lumtur: - Tani do të qajë.

- Derr, - tha Martini me zërin që i dridhej.
- Derr budalla.
- Ke të drejtë, - tha Ivani. - Ky është gati të qajë.
- Derr.
- Derr je vetë.
- Ti je derr.
- Jo, ti.

Pastaj nuk po iu binte ndonjë fjalë tjetër në mendje. Kur u sigurua se i pushuan lotët, Martini i nguli sytë tej dritares. Pa pasqyrimin e makinës që rrëshqiste nëpër vitrinat e dyqaneve në anë të rrugës: të shtrembëruar, të shtrirë, të lakuar në një gjysmërreth.

- Si është nëna jote? - pyeti Arturi.

Martini hezitoi. Si duhej t'i përgjigjej kësaj? Arturi ia kishte bërë këtë pyetje edhe në fillim, shtatë vjet të shkuar, kur u takuan për herë të parë. I ati i ishte dukur shumë i gjatë, por edhe i lodhur e i papranishëm, si të ishte i rrethuar nga një mjegull e hollë. Ndiante turp nga ky njeri, por në të njëjtën kohë, pa mundur të thoshte përse, edhe keqardhje.

“Si është nëna jote?”, kishte thënë i panjohuri dhe Martini pyeste veten, nëse ky ishte vërtet njeriu që kishte takuar aq shpesh në ëndrrat e tij, gjithmonë me të njëjtën mushama shiu të zezë, gjithmonë pa fytyrë. Por vetëm atë ditë, në dyqanin e akullores, ndërkohë që rrëmonte tasin me fruta dhe krem çokollate, Martini e kuptoi fare mirë se sa shumë i pëlqente të

mos kishte fare baba. Asnjë model, asnjë paraardhës dhe asnjë barrë, por vetëm idenë e paqartë të dikujt që mund të shfaqej një ditë. Dhe ky duhet të ishte ai? Dhëmbët e tij nuk ishin shumë të drejtë, flokët i kishte të ngatërruar, kishte një njollë në jakë dhe duart i dukeshin të rrëgjua. Ishte një njeri, siç mund të kishte qenë edhe dikush tjetër; një njeri, që dukej si ndonjë nga të shumtit në rrugë, në tren, kudo.

- Sa vjeç je saktësisht?

Martini u gëlltit dhe më pas i tha: - Shtatë vjeç.

- Kjo është kukulla jote?

Martinit iu desh një moment për ta kuptuar se babai e kishte pyetur për *zonjën Myler*. E kishte me vete si gjithmonë, e mbante nën sqetull pa e vrarë mendjen.

- Si quhet? - Martini ia tha.

- Emër i çuditshëm.

Martini nuk dinte si të përgjigjej. *Zonja Myler* ishte quajtur gjithmonë kështu, ishte thjesht emri i saj. Ai vuri re se po i rridhte hunda. Pa përreth, por mamaja s'dukej askund. Sapo kishte hyrë Arturi, ajo kishte dalë në heshtje nga dyqani i akullores.

Sado shpesh e solli ndër mend më vonë Martini atë ditë dhe sado që u përpoq ta nxirrte bisedën e tyre nga errësira e kujtesës së tij, nuk ia doli. Ndoshta sepse e kishte imagjinuar këtë bisedë shumë herë më parë dhe gjërat që në të vërtetë i thanë njëri-tjetrit, ishin bërë shpejt njësh me gjërat të cilat ai i kishte shpikur ndër vite: a i kishte thënë vërtet Arturi se nuk punonte dhe se e shpenzonte kohën duke menduar për jetën apo,

vetëm më vonë, kur Martini mësoi më shumë për të atin, mendoi se kjo ishte e vetmja përgjigje?

Amund të ndodhte që, kur e pyeti Arturin pse i kishte braktisur atë dhe nënën, ai të ishte kundërpërgjigjur vërtet se kushdo që i dorëzohet robërisë, jetës së vogël, mediokritetit dhe dëshpërimit, s'mund të ndihmojë askënd tjetër, sepse as atë s'mund ta ndihmojë askush, kur e zë kanceri apo kur i dhjamoset zemra; nuk jeton gjatë dhe kalbet, ndërsa trupi i tij ende frymon. Arturi ishte plotësisht i aftë t'i jepte përgjigje të tillë një shtatëvjeçari, por Martinin i dukej e pamundur që ai vetë të kishte guxuar t'ia bënte atë pyetje.

Pas tre muajsh i ati u kthye sërish. Këtë herë e mori Martinin nga shtëpia në një makinë me dy djem të ngjashëm e të frikshëm në sediljen e pasme; në fillim Martini mendoi mos ishte iluzion optik. Ata të dy, nga ana tjetër, e kishin parë shkurtimisht dhe vetëm me kureshtje të përmbajtur; ishin shumë të përqendruar te vetja, të kapur në enigmën e dyfishimit të tyre.

- Ne vazhdimisht mendojmë të njëjtën gjë.

- Edhe nëse janë gjëra të komplikuar. Pikërisht të njëjtat gjëra.

- Nëse na pyet dikush diçka, na vjen gjithmonë e njëjta përgjigje në mendje.

- Edhe nëse është e gabuar.

Mandej ata qeshën me të njëjtin zë identik, dhe një drithërimë përshkoi shpinën e Martinin.

Që nga ajo kohë, babai dhe vëllezërit e merrnin rregullisht. Ata kishin hipur në slita, kishin vizituar

akuariume me peshq të përgjumur, kishin ecur përmes pyjeve në periferi të qytetit, kishin notuar në pishina me erë klori, të mbushura me fëmijë që bërtisnin nën rrezet e diellit. Përpjekjet që bënte Arturi ishin gjithmonë të dukshme, ai kurrë nuk e kishte marrë seriozisht, edhe binjakët nuk ishin shumë të mirë për ta fshehur faktin se vinin aty bashkë me të, vetëm sepse duhej. Edhe pse Martini e kishte kuptuar qartë këtë gjë, ato kishin qenë pasditet më të bukura të jetës së tij. Herën e fundit Arturi i kishte dhuruar një kub shumëngjyrësh, faqet e të cilit mund t'i rrotulloje; një lodër e re, që sapo kishte dalë në treg. Martini kishte kaluar orë të tëra me të, mund të kishte kaluar ditë të tëra, ishte plotësisht i varur prej tij.

- Martin!

Ai u kthye përsëri.

- Mos po fle?

Mendoi ta godiste sërish, por ndërroi mendje. Nuk ia vlente, Eriku ishte më i fortë.

“Sa keq”, mendoi Eriku. Ai do të kishte dashur t'i jepte një shuplakë Martinit në fytyrë, por atë çast nuk kishte asgjë kundër tij. Thjesht e zemëroi fakti që i vëllai ishte aq i pafuqishëm, aq i heshtur dhe i frikësuar. Veç kësaj, ai ende kishte neveri nga ato çaste shtatë vjet më parë, kur prindërit i kishin thirrur në dhomën e ndenjjes në mbrëmje, për t'u thënë diçka të rëndësishme.

- Mos do të divorcoheni? - kishte pyetur Ivani.

Prindërit e kishin mohuar të tronditur, duke thënë: “Jo, jo, vërtet, jo; jo!” Dhe Arturi u kishte treguar për ekzistencën e Martinit.

Eriku ishte habitur aq shumë, sa vendosi menjëherë të reagoje si ndaj diçkaje qesharake, por, sapo u bë gati të merrte frymë dhe të qeshte, pranë tij Ivani kishte filluar ndërkohë të zgërdhihej. Kështu ndodhte kur ishte një dhe dy në të njëjtën kohë, e kur asnjë mendim nuk mund t’i përkiste vetëm njërit.

- Kjo nuk është për të qeshur, - u kishte thënë Arturi.

“Po pse tani?”, donte të pyeste Eriku, veçse Ivani ishte treguar sërish më i shpejtë:

- Pse tani?

- Gjërat ndonjëherë janë të vështira, - ishte përgjigjur Arturi.

I pafuqishëm, kishte hedhur sytë nga nëna e djemve, por ajo, e ulur e me krahë të kryqëzuar, u tha se edhe të rriturit nuk janë gjithmonë të mençur.

Nëna e djalit tjetër, shpjegoi Arturi, nuk kishte dashur të fliste me të, nuk kishte dashur që ai ta takonte të birin; dhe ai ishte bindur, thënë sinqerisht, me shumë dëshirë, sepse kjo ia kishte bërë më të lehtë gjendjen, por vetëm së fundmi kishte ndryshuar mendje. Ndaj tani do të nisej ta takonte Martinin.

Eriku nuk e kishte parë kurrë më parë babanë nervoz. Kujt i duhej ky Martini, mendoi ai, dhe si mund t’ua kishte bërë Arturi diçka kaq komike. Eriku e dinte me kohë se donte të ishte ndryshe nga i ati. Ai

donte të bënte para, donte ta merrnin seriozisht, nuk donte të ishte dikush që mëshirohej fshehtas. Kështu, që ditën e parë në shkollën e re sulmoi djalin më të gjatë të klasës, sigurisht, pa paralajmërim; befasia i kishte dhënë avantazhin që i duhej: Eriku e kishte shtyrë përtokë, më pas ishte gjunjëzuar mbi të duke e kapur nga veshët e duke ia përplasur kokën në dysheme tri herë, derisa ndjeu dorëzimin e tjetrit. Dhe atëherë, vetëm për të bërë përshtypje, e goditi mirë në hundë; gjakderdhja nga hundët nuk dështonte kurrë në bërjen e efektit. Sigurisht, djali trupmadh, të cilit tashmë i vinte keq për Erikun, kishte shpërthyer në lot. Eriku e la të ngrihej dhe tjetri po fshinte hundët me një shami të kuqe, që ia mbulonte fytyrën. Që atëherë Erikut ia kishte frikën e gjithë klasa, por askush nuk e kuptoi se sa i frikësuar ishte ai vetë.

Gjithçka e rëndësishme arrihej me vendosmëri, Eriku tashmë e dinte. Qofshin mësuesit, nxënësit e tjerë apo edhe prindërit e tij, të gjithë ishin në mosmarrëveshje me veten, të gjithë të dyzuar dhe me gjysmë zemre, çfarëdo që bënin. Askush s'e ndalonte dot dikë që luftonte me të vërtetë për të arritur qëllimin. Kjo ishte po aq e sigurt, sa është e sigurt se dy herë pesë bëjnë dhjetë, ose që rrethohemi nga fantazma, format e të cilave shiheshin vetëm ndonjëherë në muzg.

- Kam humbur rrugën, - tha Arturi.

- Edhe këtë herë, - tha Eriku.

- Është mashtrim, - tha Ivani. - Sepse nuk ke dëshirë.



- Sigurisht që nuk kam dëshirë. Por nuk është mashtrim.

Arturi ngau në anë të rrugës, mandej zbriti. Ajri i ngrohtë i verës hyri brenda, makinat kalonin me shpejtësi, mbante erë benzine. Ai pyeti njerëzit jashtë për rrugën: një grua e moshuar tundi dorën, një djalë me patina as nuk u ndal, një burrë me kapelë të madhe bënte sinjale me dorë për djathtas, majtas, lart dhe poshtë. Për do kohë Arturi foli me një grua të re. Ajo përkuli kokën nga njëra anë, Arturi buzëqeshi, ajo tregoi me gisht për diku, Arturi pohoi me kokë dhe i tha diçka, ajo qeshi, pastaj ajo foli, ndërsa ai qeshi, pastaj ata u përshëndetën dhe ajo i preku shpatullën kalimthi. Ende duke buzëqeshur, ai hyri brenda në makinë.

- A ta shpjegoi? - pyeti Ivani.

- S' ishte nga ky vend. Por ma tha burri para saj.

Ai bëri dy kthesa dhe para tyre u hap hyrja e një parkimi. Eriku kishte ngulur sytë i shqetësuar në errësirë. Nuk do të ishte në gjendje kurrë ta shpjegonte sa keq ndihej në çdo tunel, shpellë apo vend të mbyllur. Ivani ndoshta e dinte me siguri, ashtu siç i ndodhte çdo herë Erikut, që kishte mendimet e vëllait binjak në vend të mendimeve të tij, dhe që i shfaqeshin në kokë fjalët, të cilat tjetri s'mund t'i thoshte. Gjithashtu, i ndodhte shpesh që, pasi zgjohej, të kujtonte ëndrra me ngjyra krejt të panjohura - ëndrrat e Ivanit ishin më shumë ngjyrëse se të tijat, ato ishin çuditërisht më të largëta, ajri dukej më i mirë brenda tyre. E megjithatë,

ata edhe mund të fshihnin gjëra nga njëri-tjetri. Eriku nuk e kishte kuptuar kurrë pse Ivani kishte frikë nga qentë, kur qentë ishin një nga krijesat e pakta vërtet të padëmshme; ai nuk e kuptonte pse Ivani preferonte të fliste me vajzat bionde më shumë sesa me flokëzezat dhe nuk mund ta kuptonte pse pikturat e vjetra, të cilat atë vetëm e mërzhisin nëpër muze, të vëllait i ngjallnin ndjenja aq të ndërlikuara.

Ata zbritën. Shufrat e neoneve përhapnin dritë të zbehtë. Eriku kryqëzoi krahët dhe fiksoi sytë përdhe.

- A beson te hipnoza? - e pyeti Ivani.

- Unë mendoj se njerëzit mund t'i bindësh për çdo gjë, - tha Arturi.

Ata hynë në kabinën e ashensorit, dyert u mbyllën dhe Eriku po luftonte kundër panikut të tij. Po sikur të këputej litari? Diçka e tillë kishte ndodhur më parë, do të ndodhte përsëri dikur dhe diku, kështu që, pse jo këtu? Më në fund ashensori ndaloi, dyert u hapën dhe ata u nisën drejt teatrit. Në një banderolë shkruhej: *Lindemani i madh - mjeshtër i hipnozës. Performanca e pasdites*. Posterit tregonte një zotëri të thjeshtë me syze, i cili, pa dyshim, përpiquej të dukej i zymtë dhe depërtues. Fytyrën e kishte të hijezuar, ndriçimi ishte teatror, fotoja ishte e keqe. *Lindemani*, - shkruhej aty ngjitur, - *ju mëson t'u frikësoheni ëndrrave tuaja*.

Një djalë i ri ua kontrolloi i përgjumur biletat e hyrjes. Vendet i kishin të mira, krejt përpara, në rreshtin e tretë. Plateja ishte pothuajse plot, askush nuk ishte ulur në amfiteatër. Ivani ngriti sytë drejt tavanit

të zbukuruar dhe pyeti veten se si mund të pikturohej deri aty. Artisti kishte mashtruar me zgjuarsia sytë e vëzhguesve dhe kishte krijuar një kupolë që nuk ekzistonte. Si mund të vizatohet diçka e tillë, nëse do të tregosh se në realitet nuk ekzistonte një hapësirë e dytë, por vetëm iluzioni? Në libra nuk gjendej asgjë e tillë. Askush nuk mund të të ndihmonte. Asnjë libër, asnjë mësues. Gjithçka që kishte rëndësi duhej ta mësoje vetë dhe, nëse nuk ia dilje, humbisje lidhjen me jetën. Ivani shpesh pyeste veten sesi mund ta duronin ekzistencën e tyre njerëzit që nuk ishin në gjendje të bënin asgjë të veçantë. Ai shihte që e ëma dëshironte një jetë ndryshe, ndërsa i ati gjithmonë ishte diku tjetër me mendimet e tij. Ai shihte që mësuesit e tij në shkollë ishin shpirtra të vegjël e të trishtuar dhe, sigurisht, ai e dinte për vegimet që mundonin Erikun. Sa herë hynte në ndonjë nga ëndrrat e Erikut, e gjente veten në një vend të errët dhe të mbytur, ku nuk donte të ishte. Ai i shihte këto, edhe Martinin, i cili ishte shumë i dobët dhe shumë i vetmuar me nënën e tij. Ivani psherëtiu. Nuk i interesonte hipnoza, do të kishte dashur të kthehej në shtëpi dhe të vizatonte. Përfundimisht, donte të vizatonte sa më mirë, kjo ishte e vetmja gjë që vlente, nuk donte asgjë tjetër.

Drita u zbeh, murmuritja u shua. Perdja u hap. Lindemani qëndronte në skenë. Ishte i shëndoshë, tullac, çka binte më tepër në sy nga disa qime të dala mbi tullën e rrashtës së tij, dhe mbante syze të zeza fildishi. Kostumin e kishte gri dhe, në xhepin

e vogël të përparmë, kishte një shamizë jeshile. Pa përshëndetur, pa u përkulur, filloi të flasë me zë të ulët.

- Hipnoza, - tha ai, - nuk është gjumë, por është më tepër gjendje e vigjilencës së zgjuar brenda vetes, jo mungesë vullneti, por vetëfuqizim. - Gjëra të mahnitshme do të shihni sot, por askush nuk duhet të shqetësohet, sepse, siç dihet, askush nuk mund të hipnotizohet kundër vullnetit të tij dhe askush nuk është hipnotizuar ndonjëherë për të bërë diçka që, thellë në shpirtin e tij, nuk është i përgatitur ta bëjë.

Ai heshti për një moment dhe buzëqeshi, si të kishte bërë ndonjë shaka të vështirë për t'u kuptuar.

Një shkallë e ngushtë të çonte nga skena te spektatorët. Lindemani zbriti, rregulloi syzet, pa përreth dhe eci nëpër korridorin mes rreshtave. Natyrisht, ai tani po vendoste se cilët persona do të sillte në skenë. Ivani, Eriku dhe Martini ulën kokat.

- Mos u shqetësoni, - tha Arturi. - Ai merr vetëm të rritur.

- Atëherë, ndoshta të merr ty.

- Nuk funksionon me mua.

- Jemi përpara ngjarjesh të mëdha, - tha Lindemani.

- Ata që nuk duan të marrin pjesë, nuk duhet të frikësohen, nuk do t'iu afrohem shumë, do t'i kursej.

Ai arriti në rreshtin e fundit, vrapoi prapa me shkathtësi të çuditshme dhe u hodh në skenë.

- Po fillojmë me diçka të lehtë, - tha ai. - Vetëm me një shaka, me një gjë të vogël. I gjithë rreshti i parë, ju lutem, ngrihuni!

Një murmurimë përshkoi sallën.

- E saktë, - tha Lindemani. - Rreshti i parë. Të gjithë. Ju lutem, shpejt!

- Çfarë bën ai, nëse dikush refuzon? - pëshpëriti Martini. - Nëse dikush nuk ngrihet fare nga vendi, çfarë ndodh atëherë?

Të gjithë njerëzit në rreshtin e parë u ngritën në këmbë. Ata pëshpëritën me njëri-tjetrin dhe panë përreth të indinjuar, por u bindën dhe u ngjitën në skenë.

- Vendosuni në një rresht! - urdhëroi Lindemani. - Kapuni për duarsh!

Ata u bindën me ngurrim.

- Mos e lëshoni më njëri-tjetrin, - tha Lindemani teksa ecte përgjatë rreshtit të formuar. - Nuk doni, prandaj nuk do ta bëni dhe, sepse nuk doni, nuk do të mundeni e, meqenëse nuk mundeni, nuk është gabim të mendoni se jeni të ngjitur me njëri-tjetrin.

Teksa fliste, ai i kapte sa andej këtej njerëzit dhe ua prekte duart.

- Shtrëngojini duart fort, - tha ai. - Shtrëngojini fort, shumë fort! Tani askush nuk mund të shkëputet, askush nuk mund t'i shkëpusë duart e shtrënguara fort e në mënyrë të pazgjidhshme. Kushdo që dëshiron, le ta provojë në këtë çast. Askush nuk u shkëput. Lindemani u kthye nga publiku, pati tentativa duartrokitesh. Ivani u përkul përpara për të parë më mirë fytyrat e njerëzve në skenë. Ata dukeshin të pavendosur; të pavendosur dhe të ngrirë nga një

ngërç vullneti. Nofullat e një burri shtatshkurtër u shtrënguan, një zonje me bishtaleca iu drodh dora, sikur të kishte në plan të çlirohej, por shtrëngimi i duarve të fqinjit, ashtu edhe i të sajave, ishte shumë i fortë.

- Do të numëroj deri në tre, - tha Lindemani, - dhe më pas të gjitha duart do të çlirohen. - Pra, një. Dhe dy. Dhe...

Ai ngriti dorën ngadalë, tha: "Tre!", dhe njerëzit u shkëputën.

Të pavendosur, pothuajse pa dëshirë, u lëshuan. Të zënë ngushtë, ata panë duart e tyre.

- Tani uluni sërish shpejt, - tha Lindemani. - Shpejt poshtë, shpejt! - Ai përplasi duart.

Gruaja me bishtaleca ishte e zbehtë dhe po lëkundej ndërsa ecte. Lindemani e kapi lehtë nga bërryli, e çoi te shkallët dhe i foli me butësi. Kur e la të lirë, ajo lëvizti me hap më të sigurt, zbriti shkallët dhe arriti në vendin e saj.

- Ky ishte një eksperiment i vogël, - tha Lindemani, - një shaka sa për fillim. - Tani le të bëjmë diçka serioze. - Ai u ngjiti mbi pod, hoqi syzet dhe picërroi sytë:

- Zotëria përballë me pulovër, zotëria pas tij dhe ju, zonjushë, ju lutem, ejani lart!

Të tre u ngjitën në skenë duke buzëqeshur me mundim. Gruaja ia bëri me dorë dikujt, Lindemani tundi kokën në mënyrë mohuese, ajo ndaloi. Ai u vendos pranë të parit, një burri të gjatë me mjekër,

dhe ia mbuloi sytë me dorë. Për njëfarë kohe i foli në vesh dhe papritmas i bërtiti: “Fli!” Burri u lëshua, Lindemani e kapi dhe e shtriu në tokë. Më pas shkoi te gruaja pranë tij dhe ndodhi po e njëjta gjë. Po kështu veproi edhe me burrin tjetër. Ata gjendeshin shtrirë, të palëvizshëm. “Dhe tani lumturohuni!”

Ai duhet ta shpjegonte këtë. Lindemani u kthye nga salla, hoqi syzet e fildishta, nxori shaminë jeshile nga xhepi i gjoksit dhe zuri t’i pastronte.

- Ne të gjithë dimë mjaftueshëm për sugjestionë të çmendura, që hipnotizues mediokër - të vetëkënaqur e pa talent, siç janë me bollëk në çdo profesion - dëshirojnë të rrënjosin te subjektet e tyre të ftohtin ose të nxehtin, ngurtësinë fizike, fantazitë e fluturimit ose të rënies, e të mos flasim për harresën popullore të emrave të tyre!

Ai ndaloi dhe pa mendueshëm në ajër. - Është nxehtë këtu, apo jo? Tmerrësisht nxehtë! Çfarë po ndodh? - Ai fshiu ballin. - Gjëra të tilla naive, siç thashë, janë parë aq shpesh, sa do t’i kaloj pa u zgjatur shumë. O Zot, sa nxehtë!

Ivani shtyu flokët e lagur nga balli. Ngrohtësia dukej se po ngrihej valë-valë nga dyshemeja, ajri ishte i lagësht. Edhe fytyra e Erikut shkëlqente. Kudo bënë fresk fletushkat e programit, duke u valëvitur në ajër.

- Tani patjetër që duhet bërë diçka, - tha Lindemani. - Mos u shqetësoni, pa dyshim që po punohet, teatri ka teknikë të zotë. Sistemi i shkëlqyer i ajrit të

kondicionuar do të aktivizohet menjëherë. Ndoshta tani ka ardhur koha. Nga lart tashmë mund të dëgjohet zhurma e makinerive ftohëse. Mund të ndihet edhe era. - Ai ngriti jakën. - Tani po fryn vërtet shumë. Sistemi ka fuqi të mahnitshme. - Ai hukati në duart e tij dhe po ecte sa me një rën këmbë, me tjetrën. - Është ftohtë këtu, shumë ftohtë, tmerrësisht ftohtë!

- Çfarë po ndodh? - pyeti Arturi.

- Nuk e dallon? - pëshpëriti Ivani. - Fryma e tij ngrihej në re avulli, këmbët nuk i ndiente, e kishte të vështirë të merrte frymë. Martinit po i kërcisnin dhëmbët. Eriku po ndillte hundët.

- Jo, - tha Arturi.

- Asgjë fare?

- Të thashë më përpara se me mua nuk funksionon hipnoza.

- Mjaft me kaq, - tha Lindemani. - Kaq ishte. Mbaroi.

Siç tha, ai nuk donte ta humbiste kohën e askujt me shaka të tilla. Tani do të vinte në veprim pa vonesë diçka interesante, domethënë manipulimin e drejtpërdrejtë të forcave shpirtërore. Tre zotërinjtë mbi dysheme po ndiqnin udhëzimet e tij prej njëfarë kohe. Ata ishin të lumtur. Tani për tani, këtu dhe para të gjithëve, ata po jetonin momentet më të mira të jetës së tyre.

- Ngrihuni!

Ata u ngritën me siklet dhe ndenjën të ulur me trupin drejt.



- Tani vështro, - i tha Lindemani gruas në mes.

Ajo hapi sytë. Gjoksi i ngrihej e i ulej. Kishte diçka të çuditshme në mënyrën sesi ~~po~~ merrte frymë dhe sesi i lëviznin sytë. Ivani nuk e kuptoi mirë, por dyshoi për diçka të madhe dhe të ndërlikuar. Ai vuri re se një grua në rreshtin përpara tyre i hoqi sytë nga skena. Burri pranë saj tundi kokën me neveri.

- Mbyllini sytë, - tha Lindemani.

Sytë e gruas në skenë u mbyllën menjëherë. Goja e saj ishte e hapur, një spërkë e hollë pështyme i rridhte teposhtë, faqet i shkëlqenin nën dritën e skenës.

- Për fat të keq, - tha Lindemani, - asgjë nuk zgjat përgjithmonë dhe bukuritë përfundojnë gjithmonë të parat. - Jeta tani duket thjesht e madhërishtme dhe e mrekullueshme, por e vërteta është se asgjë nuk mbetet, gjithçka kalbet, gjithçka vdes, pa dallim. Ajo ndrydhet pothuajse gjithmonë. Por jo tani; jo, jo në këtë moment. Tani ju e dini këtë.

Burri me mjekër rënkoi. Gruaja u spraps ngadalë dhe vuri duart mbi sy.

Burri tjetër po qante me zë të ulët.

- Por njeriu duhet të jetë ende i lumtur, - tha Lindemani. - Një ditë e shkurtër mes dy netëve pafundësisht të gjata është jetë, ndaj duhet t'i shijoni edhe më shumë minutat e ndritshme dhe të kërceni, për sa kohë dielli ende shkëlqen. - Ai përplasi duart.

Të tre u ngritën të bindur. Lindemani duartrokiti ritmikisht, në fillim ngadalë, pastaj më shpejt. Ata kërcyen si marioneta, duke hedhur gjymtyrët dhe

duke rrotulluar kokat. Ishte shumë qetësi, askush nuk kollitej e as nuk kruante fytin, ankthi dukej se kishte zbritur mbi spektatorët. Gjithçka që mund të dëgjoje nga skena ishin gulçimi, rrahjet dhe kërcitja e dërrasave.

- Tani shtrihuni sërish, - tha Lindemani, - dhe ëndërroni!

Dy prej tyre ranë menjëherë përmbys, burri krejt në të majtë mbeti në këmbë dhe po bënte ca lëvizje me dorë, por më pas gjunjët e tij u përthyen dhe nuk lëvizi më. Lindemani u përkul përpara dhe e vështroi me kujdes. Më pas iu drejtua publikut.

Tani ai dëshironte të kryente një eksperiment të vështirë. Vetëm pak vetë mund ta bëjnë këtë; kërkon shkollim të epërm.

- Ëndërroni thellë. Thellë e më thellë se kurrë. Ëndërroni një jetë të re. Bëhuni fëmijë, mësoni, rrituni, luftoni, vuani dhe shpresoni, fitoni dhe humbni, dashuroni dhe humbni sërish, plakuni, dobësohuni, bëhuni të brishtë dhe më pas vdisni; kjo ndodh shumë shpejt, e ndërsa unë flas kështu, kur ju të hapni sytë, e gjitha kjo nuk do të ketë ndodhur kurrë.

Ai shtrëngoi duart, u kthye nga publiku dhe qëndroi në heshtje për disa sekonda të mira.

- Kjo përpjekje, - tha më pas, - jo gjithmonë ka sukses. - Shumë persona testues zgjohen dhe nuk kanë përjetuar ndërkohë asgjë. Të tjerë do t'i luteshin Lindemanit t'ua fshinte ëndrrën nga kujtesa e tyre, sepse përjetimi ishte shumë shqetësues, për t'i besuar më pas sërish kohës dhe realitetit.

Ai vështroi orën. - Ndërkohë, për të mbushur kohën e pritjes, po bëjmë disa gjëra të thjeshta. Ka fëmijë në sallë? - U ngrit në majë të gishtave. - Ai i rreshtit të pestë, ajo vajza e vogël atje në fund dhe ai djaloshi te rreshti i tretë, që duket njësoj si tjetri pranë tij. Ngjituni lart!

Ivani vështroi në të djathtë e në të majtë të tij.

Pastaj tregoi veten me gisht mbi gjoks.

- Po, - tha Lindemani, - ti.

- Më the se ai merr vetëm të rritur, - pëshpëriti Ivani.

- E po, gabova këtë herë.

Ivani ndjeu si i pulsonte gjaku në fytyrë. Zemra i rrihte fort. Dy fëmijët e tjerë ishin tashmë në rrugën e tyre drejt skenës. Lindemani e vështroi pa ia ndarë sytë.

- Mund të rrish ulur, - i tha Arturi. - Ai s'mund të të urdhërojë.

Ivani u ngrit ngadalë. Vështroi përreth. Të gjithë po e shikonin, të gjithë në sallë, çdo person aty në teatër. Jo, Arturi gaboi, nuk mund të refuzonte; në fund të fundit, ishte një shfaqje për hipnozën, e kushdo që vinte këtu duhej të merrte pjesë.

Ai dëgjoi Arturin t'i thoshte diçka tjetër, por nuk e kuptoi, zemra po i rrihte shumë fort dhe tashmë u gjend duke bërë përpara. U shty nëpër gjunjët e njerëzve të ulur dhe eci mes rreshtit drejt skenës.

Sa ndriçim kishte aty lart! Dritat e prozhektorit ishin më të forta seç i priste dhe njerëzit në sallë vetëm

hije. Të tre të rriturit rrinin të ngurtë, asnjëri prej tyre nuk lëvizte, askush nuk dukej se merrte frymë. Ivani pa nëpër sallë, por nuk mundi t'i shquante Arturin dhe vëllezërit. Lindemani iu afrua, u ul në gjunjë, e shtyu me kujdes sikur të ishte një mobilie e brishtë, bëri një hap prapa dhe e pa në fytyrë.

- Tani do të fillojmë, - tha në heshtje.

Nga afër Lindemani dukej më i plakur. Kishte rrudha rreth gojës dhe syve, dhe nuk e kishte bërë grimin me kujdes. Nëse dikush do ta pikturonte portretin e tij, do t'i duhej të përqendrohej te sytë e thellë pas syzeve prej fildishi: sy të shqetësuar, të vështirë për t'u parë; me sa duket s'ishte e vërtetë se hipnotizuesit t'i ngulnin sytë në fytyrë, që të përumbesh në vështtrimin e tyre. Përveç kësaj, atij i vinte erë mente.

- Si e ke emrin? - e pyeti disi më fort.

Ivani u gëlltit dhe ia tha.

- Relaksohu, Ivan, - i tha Lindemani me zë aq të lartë, sa ta dëgjonte publiku i rreshtave të parë.

- Bashkoji duart, Ivan! Gërshetoji gishtat.

Ivani e bëri, duke pyetur veten sesi mund të relaksohej në një skenë para aq shumë njerëzve. Lindemani nuk mund ta kishte menduar seriozisht këtë; ndoshta e tha vetëm për ta çoroditur.

- Kështu, në rregull.

Lindemani tani po u fliste të tre fëmijëve me zë aq të lartë, sa mund të dëgjohej në të gjithë sallën.

- Krejt të qetë, krejt të relaksuar, vetëm duart nuk mund t'i çlironi; nuk mundeni, sepse ato janë ngjitur me njëra-tjetrën.

Kjo nuk ishte e vërtetë! Ivani mund t'i kishte çliruar duart lehtësisht, nuk kishte asnjë rezistencë dhe asnjë pengesë. Por atij nuk i interesonte ta vinte në siklet Lindemanin. Thjesht donte të përfundonte sa më shpejt.

Lindemani fliste e fliste pa u ndalur. Fjala “relaksim” vazhdoi të përsëritej disa herë dhe ai vazhdoi të thoshte diçka për dëgjimin dhe bindjen. Ndoshta kjo funksionoi për dy të tjerët, por nuk funksionoi për Ivanin. Ai nuk ndihej ndryshe nga më parë, nuk bëhej fjalë për gjendje transi. Vetëm hunda i kruhej. Dhe i shkohej në tualet.

- Provoje, - i tha Lindemani djalit pranë Ivanit.  
- Nuk mund t'i zgjidhësh duart, nuk mundesh; ja, provoje, nuk mundesh!

Ivani dëgjoi një zhurmë të thellë, gjëmuese; vetëm pas disa çastesh e kuptoi se ishte e qeshur. Publiku po qeshte me ta. “Por jo për mua, - mendoi Ivani, - ai duhet ta ketë vënë re që nuk po i funksionon me mua, ndaj nuk më pyet.”

- Ngrini këmbën tuaj të djathtë, - u tha Lindemani.  
- Të tre. Tani.

Ivani pa dy të tjerët të ngrinin këmbën. Ndjeu sytë e të gjithëve mbi të. Ishte djersitur. Pra, çfarë i mbetej të bënte? Ngriti këmbën. Tani të gjithë do të mendonin se ai ishte hipnotizuar.

- Harroje emrin tënd, - i tha atij Lindemani.

E ndjeu zemërimin t'i rritej brenda vetes. Gradualisht po bëhej shumë budalla. Nëse burri do ta pyeste përsëri, do ta turpëronte para të gjithëve.

- Thuaje emrin!

Ivani pastroi fytyrën.

- Nuk mundesh, e ke harruar, nuk mundesh. Si e ke emrin?

Ndoshta nga situata, nga ndriçimi i tmerrshëm dhe nga fakti që s'ishte e lehtë të qëndroje në një këmbë para kaq shumë njerëzve, duhej i gjithë përqendrimi i mundshëm të mbaje ekuilibrin.

Nuk ishte kujtesa, jo, ishte zëri që s'iu bind. I ngeci në fytyrë dhe nuk po i dilte. Çfarëdo që ta pyesnin tani, ai duhet të rrinte i heshtur.

- Sa vjeç je?

- Trembëdhjetë, - dëgjoji veten të thoshte. Kështu, me pak vullnet ia doli.

- Si është emri i nënës?

- Katerina.

- Po i babait?

- Artur.

- Mos është ai zotëria atje poshtë?

- Po.

- Po ti si quhesh? - Ai heshti.

- Nuk e di emrin tënd?

Sigurisht që e dinte. I ndjeu konturet e emrit të tij; e dinte se ku gjendej ai emër në kujtesën e tij; e ndiente, por i dukej se ai që mbante atë emër ishte një tjetër